

VENDIM
Nr. 95, datë 17.6.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES “PËR KUSHTET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16, nenit 20, germa “g”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.6.2016, pasi shqyrtoi relacionin e drafttregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e drafttregullores “Për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti